

# **A Duhet Paragjykuar Rritja e Çmimit të Ujit të Propozuar nga Shoqëritë e UK?**

Morëm shkas për të shkruar këtë artikull jo vetëm nga konstatimi i kahershëm që duhet bërë më shumë për të informuar publikun për problemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në tërësi, por sidomos nga zhvillimet e fundit në sektorin e ujit ku u rrit çmimi i ujit për konsumatorët nga shoqëria UK Durrës, si dhe propozimi për rritjen e tyre edhe nga shoqëria UK Tiranë. Në fakt aprovimi i tyre ligjërisht është kompetencë ekskluzive e Entit Rregullator Kombëtar të Ujit (ERRU).

## **Të përgjithshme mbi performancën e sektorit të ujit**

Duhet thënë që sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në përgjithësi ka performancë të ulët financiare. Vetëm 19 nga 58 shoqëri UK që operojnë aktualisht në vend arrijnë të mbulojnë kostot direkte të operimit e mirëmbajtjes së tyre. Diferenca e kostove për 38 shoqëri UK të tjera që përfaqësojnë 32% të popullsisë së vendit subvencionohen nga qeveria qendrore me rreth 1 miliard lekë ose rreth 8 milion Euro në vit.

Shpenzimet direkte të operim mirëmbajtjes përmbajnë kostot e energjisë elektrike, pagat, kimikatet, karburantet, difektet të ndryshme, si dhe shpenzime të tjera administrative, ndërsa kostot totale përfshijnë edhe kostot për investimet fizike në sisteme dhe të kredive të ndryshme. Aktualisht në të gjithë sektorin e ujit kostot totale arrin ti mbulojë vetëm shoqëria UK Korçë. Theksohet fakti që nevojat për investime fizike në sektor vlerësohen me rreth 160 milion Euro në vit për një shtrirje kohore 22 vjeçare, shifër e cila është mjaft e vështirë të përballohet vetëm nga buxheti i shtetit.

Shoqëritë UK ofrojnë për konsumatorët në përgjithësi shërbime me cilësi të ulët. Kjo evidentohet nga fakti që vetëm shoqëritë e UK Korçë, UK Pogradec dhe UK Librazhd ofrojnë shërbim të vazhdueshëm 24 orë në ditë.

Përmirësimi i performancës financiare dhe cilësisë së shërbimeve të shoqërive UK është i lidhur ngushtë me dy elementë kryesore, përkatësisht me atë të përmirësimit të manaxhimit nga stafet e shoqërive UK që lidhet me uljen e humbjeve administrative (lidhjet ilegale, nënfaturimet etj), si dhe të nevojave për investime fizike që ulin humbjet fizike në rrjete (çarjet e tubave, rrjedhjet nga galexhantët etj).

## **Roli dhe kompetencat ligjore të ERRU-së**

Siç u theksua më sipër të drejtën ekskluzive ligjore të aprovimit të çmimeve të reja për ujin që propozohen nga shoqëritë UK e ka ERRU.

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve kanë karakter monopol sepse i ofrohen konsumatorit vetëm nga një shoqëri UK pa patur mundësi zgjedhje midis disa ofruesve alternativë siç është p.sh. rasti i shërbimeve të telefonisë celulare. Në këtë rast ekziston rreziku që nga shoqëria që i ofron ato mund të abuzohet në vendosjen e çmimeve të ekzagjeruara për konsumatorët. Pikërisht analiza profesionale e propozimeve të shoqërive UK për çmime të reja për ujin dhe aprovimi i tyre nga një organ i pavarur siç është ERRU-ja mbron konsumatorët nga çmime të larta të pajustificuara.

ERRU është garant për transparencën që shoqëritë UK duhet paraqesin ndaj publikut për çmime e propozuara për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve. Shoqëritë UK janë të detyruara ligjërisht që të zhvillojnë seanca degjimore me publikun për çmimet e reja që ato propozojnë për aprovim tek ERRU. Ky është një element mjaft i rëndësishëm që rrit bashkëpunimin me publikun që të kontribuojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe efincencën financiare të tyre. ERRU së fundmi ka

përmirësuar udhëzuesin përkatës që seancat dëgjimore me publikun të mos zhvillohen formalisht, por t'i shërbejnë ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të konsumatorëve me shoqëritë UK.

ERRU është gjithashtu autoriteti që licencon shoqëritë UK, si garant që këto të fundit të kenë aftësinë profesionale për dhënien e shërbimeve sipas standarteve të kërkuara.

Roli i ERRU-së nuk është i njëanshëm vetëm në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorit. ERRU luan një rol mjaft të rëndësishëm për qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK. Ky ndoshta është edhe pozicioni delikat, të cilin ERRU si Rregullator përpiqet maksimalisht ta luajë me maturinë dhe profesionalizmin e duhur duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e realitetit të sektorit të ujit dhe të shoqërisë sonë, pra që të mbrohet konsumatori (publiku) nga abuzimet e çmimeve të pajustificuara dhe të kontribuojë për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

## **Propozimi i rritjes së çmimit të ujit nga shoqëria UK Durrës**

Shoqëria UK Durrës ofron shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime në një zonë shërbimi që përfshin bashkitë e Kurbinit, Krujës, Shijakut dhe Durrësit për një popullsi rreth 400 mijë banorë. Kuptohet në periudhën e verës popullsia rritet në mënyrë të konsiderueshme nga turistët. Ujësjiellësi i Durrësit së bashku me atë të Tiranës janë ujësjiellësit më të mëdhenj të Shqipërisë dhe njëkohësisht me problematikët për t'u menaxhuar.

Sistemi kryesor i furnizimit me ujë që administron UK Durrës është ai që merr ujë nga Fushë Kuqe me ngritje mekanike nga rreth 44 km larg qytetit të Durrësit, i cili gjatë rrugës furnizon me ujë të gjithë zonën rurale. Ky ujësjiellës është ndërtuar në vitin 1972 (45 vjet më parë) për të plotësuar nevojat e një popullsie shumë më të vogël sesa ajo e sotme, e cila është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga migracioni i pakontrolluar i dy dekadave të fundit.

Nga ana financiare UK Durrës operon me humbje duke mbuluar vetëm 88% të kostove të O&M, diferenca e së cilës mbulohet me subvencione nga qeveria qendrore. UK Durrës operon me një tregues të Ujit Pa të Ardhura 72%.

Banka Botërore është duke financuar me një kredi prej rreth 65 milion Euro për të ndërtuar një sistem të ri shtesë furnizimi me ujë nga Fushë Kuqe i destinuar kryesisht për qytetin e Durrësit, ndërsa ai ekzistues do të shërbejë për zonën rurale.

Projekti është i lidhur ngushtësisht me objektiva që UK Durrës duhet të arrijë sipas Planit të Biznesit 5 Vjeçar. Një nga këto objektiva është dhe mbulimi 100% të kostove të O&M brenda vitit 2017, ku faktori kryesor për realizimin e të cilit ishte rritja e çmimit të ujit nga 61 lek/m<sup>3</sup> në 70 lek/m<sup>3</sup>. Analiza e plotë e veprimtarisë së një ujësjiellësi është e pamundur të trajtohet në kuadrin e këtij artikulli, por në mënyrë të përmbledhur përmendim se ERRU analizoi me vëmendje të veçantë propozimin e UK Durrës për rritjen e çmimit të ujit në lidhje me realizimet në përmirësimin e performancës së shoqërisë gjatë vitit 2016. Në përfundim në marrjen e vendimit që aprovon rritjen e çmimit të ujit aq sa e kishte propozuar UK Durrës dominoi arsyeimi që kjo e fundit kishte realizuar progres në performancë duke rritur vlerën e ujit të shitur me 7.6%, rritje të volumit total të arkëtimeve me 3.8%, si dhe rënie më 0,3% të Ujit Pa të Ardhura. Kjo rritje e çmimit e çliron qeverinë qendrore nga subvencioni që duhet ti japë shoqërisë UK Durrës. Ecuria e rritjes së çmimit ndjek atë të parashikuar dhe argumentuar në Planin e Biznesit, dhe përputhet edhe me kërkesën e Bankës Botërore për plotësimin e këtij kushti dhe të financimit të kredisë.

Krahas aprovimit të çmimit të ri për ujin, ERRU ka vendosur objektiva të reja për UK Durrës për vitin në vazhdim në përputhje me planin e prokurimeve të projektit të Bankës Botërore, si edhe të investimeve të financuara nga KfW dhe Qeveria Qendrore, zbatimi i të cilave fillon në Korrik 2017. Këto investime do të bëhen kryesisht në zonën rurale që paraqitet mjaft problematike në drejtim të treguesve të Ujit Pa të Ardhura dhe të shpërdorimeve në përgjithësi. Nga ana tjetër

ERRU do të monitorojë nga afër performancën e UK Durrës në plotësim të objektivave të reja të vendosura dhe në respektimin në përgjithësi të objektivave që përmban Plani i Biznesit.

### **Propozimi i rritjes së çmimit të ujit nga Shoqëria UK Tiranë**

Në Korrik të këtij viti shoqëria UK Tiranë zhvilloi seancat degjimore me publikun dhe të Keshillit Bashkiak të Tiranës për të informuar dhe marrë opinionet për çmimet e reja të propozuara të shërbimeve të ujësjelles kanalizime. Kërkesa dhe dosja e propozimeve të mësipërme ishin depozituar disa jave më parë në ERRU, e cila së bashku me relacionet (opinionet) e dy seancave të mësipërme fillon shqyrtimin e tyre në fund të muajit Gusht 2017.

Aktualisht UK Tirane i mbulon gjerësisht kostot direkte të operim mirëmbajtjes, dhe në thelb çmimet e reja të propozuara synojnë mbulimin e kostove totale, pra që përfshijnë nevojat për investime me objektivin final që mbas 5 viteve Tirana të ketë uje 24 orë në ditë.

ERRU gjatë shqyrtimit të dosjes së tarifave të reja të propozuara nga UK Tiranë do të ketë si objekt të saj sqarimin e pyetjeve të tilla thelbesore si:

A janë dhënë argumentet e duhura që justifikojnë këtë rritje të çmimit të ujit?

A është i arritshëm objektivi që Tirana gradualisht të ketë ujë 24 orë në ditë?

A është i perballueshem çmimi i ri i ujit për popullsinë dhe konsumatorët e tjerë?

Nëse argumentat e mësipërme nuk janë të plota apo të justifikuar, kush është çmimi më i arsyeshëm i ujit që ERRU duhet ta aprovojë?

Sqarimi me sa më shumë objektivitet dhe profesionalizëm i pyetjeve të mësipërme është detyrë dhe shqetësimi kryesor i ERRU-së. Prandaj le të mos i paragjykojmë apriori propozimet e rritjes së çmimeve nga shoqëritë UK në përgjithësi, por të marrim pjesë në proces në mënyrë që në përfundim të jemi sa më të bindur në verdiktin e çmimit të ujit të aprovuar nga ERRU.

**Kryetar i Entit Rregullator të Ujit**

**Ndriçim SHANI**

**Publikuar:**

**Gazeta Sot  
Gusht 2017**